



Pyetje dhe Përgjigje

Thirrja e 6-të e granteve lokale dhe thirrja e 3-të e granteve rajonale

Më poshtë gjendet lista e pyetjeve dhe përgjigjeve që ne kemi hartuar, bazuar mbi të gjitha pyetjet që na kanë mbërritur në postën elektronike mes 23 janarit dhe 20 marsit 2020.

	Pyetje	Përgjigje
SITUATA E KORONAVIRUSIT		
1	Si rrjedhë e situatës së COVID-19, a do të shtyhen afatet e aplikimit?	Aktualisht nuk ka asnjë plan për të shtyrë afatet e aplikimit, por nëse do të vendoset për shtyrjen e tyre, ne do të njoftojmë në faqen tonë web dhe në facebook.
2	A ka mundësi për shtyrje aktiviteteve në rast se situata me COVID-19 vazhdon? Cilat janë opsionet dhe zgjidhjet që mund të jepen në këtë rast? A na nevojitet të rishkruajmë propozimin duke patur në mendje situatën?	Ne e ndjekim me shqetësim të madh zhvillimin e situatës së COVID-19 dhe jemi të vendosur t'i përmbahemi plotësisht rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe masave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare. Ndërkohë që është e pamundur të dihet kohëzgjatja e kësaj situatë dhe skenarët e mundshëm që mund të shpalosen, ne jemi të angazhuar që të punojmë së bashku me partnerët tanë për të gjetur zgjidhjet më të mira në menaxhimin e sigurt të projekteve. Ne do ta vlerësojmë nëse aplikuesit marrin parasysh risqet e mundshme dhe propozojnë zgjidhje fleksibël në rast skenarësh të paparashikuar.
KRITERET E PRANIMIT		



3	A munden një aplikant të aplikojnë me më shumë se një projekt?	Aplikantët munden të aplikojnë vetëm me një projekt brenda një tematike të thirrjes, por janë të mirëpritur të aplikojnë në tematikat e tjera.
4	A mundet që një artist të përfshihet si kontribues në më shumë se një projekt, propozuar nga 2 organizata ose artistë të ndryshëm?	<p>Një artist me rol jo-drejtues mund të përfshihet si kontribues në më shumë se një projekt, propozuar nga dy aplikues të ndryshëm.</p> <p>Disa shembuj të roleve jo-drejtues janë: anëtarë ekipi filmimi, aktorë në role dytësore, scenografë, instrumentistë në grupe ose orkestra, etj.</p>
5	A lejohet të ftohen artistë ose anëtarë të ekipit të projektit nga një shtet tjetër, nëse vendet e aktivitetit janë vetëm në Shqipëri dhe përfituesit janë ekskluzivisht nga Shqipëria?	<p>Misioni i Fondit Kulturor Zviceran është mbështetja e artistëve të rinj dhe në zhvillim, të cilët e kanë bazën e veprimtarisë së tyre në Shqipëri.</p> <p>Mbështetur mbi këtë mision, ne i nxitim aplikuesit tanë që të punojnë me profesionistë nga Shqipëria. Sidoqoftë, nuk ndalohet përfshirja e profesionistëve nga një shtet tjetër si anëtarë projekti.</p> <p>Në këtë rast, aplikuesit duhet të japin argumente bindëse pse kanë zgjedhur një bashkëpunues nga jashtë shtetit.</p>
6	A ka kushte specifike për ata që konsiderohen aktivistë ose grupe informale?	<p>Nuk ka kushte specifike për aplikuesit përveç atyre që përmenden në udhëzimet e aplikimit.</p> <p>Në këtë thirrje ne përdorim termat "aktivist" dhe "grup informal" sipas përcaktimeve që pranohen gjerësisht në sektorin kulturor.</p> <p>Gjithsesi, dokumentet e kërkuar si CV, biografi, portofol punësh artistike, etj. janë të rëndësishme për ekipin vlerësues, për t'u siguruar që profili i aplikuesit përputhet plotësisht me objektivat e thirrjes dhe me projektin e propozuar.</p>
7	A është tema e katërt e thirrjes, "Histori nga kujtesa kolektive", e rezervuar vetëm për artistët e pavarur individë, producentët e filmit dhe kërkuesit? A munden fondacionet dhe/ose shoqatat të aplikojnë?	Kjo tematikë inkurajon aplikimet që vijnë nga artistë të pavarur, producentë filmi ose kërkues, por nuk përjashton asnjë aplikues tjetër të pranuar sipas paragrafit 2 të udhëzimeve për aplikuesit.

8	A është e pranueshme të aplikohet për një propozim që krijon ndërgjegjësim për muzetë?	<p>Thirrja jonë e granteve lokale është e hapur për një gamë të gjerë propozimesh dhe ne inkurajojmë idetë kreative që përputhen me objektivat tanë dhe kriteret e pranimit.</p> <p>Ju lutem merrni në konsideratë që Fondi Kulturor Zviceran i drejtohet ekskluzivisht skenës së pavarur të artit dhe kulturës në Shqipëri. Kështu, grupi ynë i synuar janë artistët e pavarur të rinj dhe në zhvillim.</p> <p>Sipas rregullave që udhëheqin dhe rregullojnë procedurën e përzgjedhjes, jeni të lutur të vini re që në këtë fazë ne nuk mund t'i përgjigjemi pyetjeve specifike që lidhen me konceptin e një propozimi.</p>
BUXHETET		
9	Sa grante do të jepen në total?	<p>Nuk ka një numër të paracaktuar të granteve që do të jepen në vijim të këtij procesi.</p> <p>Numri i granteve që Fondi Kulturor Zviceran do të ofrojë në këtë thirrje bazohet në cilësinë e propozimeve, sidoqoftë, nuk do të jepen më shumë se gjashtë grante lokale dhe një grant rajonal.</p>
10	Cila është vlera maksimale e grantit?	<p>Për grantet lokale, vlera maksimale është 1.000.000 Lekë.</p> <p>Për grantet rajonale, vlera maksimale është 3.000.000 Lekë.</p>
11	A rekomandoni një nivel minimal dhe maksimal kontributi të aplikuesit?	Udhëzimet tona të aplikimit nuk përcaktojnë një minimum apo maksimum të rekomanduar të kontributit të aplikuesit.
12	A ka përqindje të rekomanduara nga buxheti total për udhëtim, akomodim, roga, pajisje, kontribut aplikuesi, etj? Ose së paku për disa nga këto zëra?	<p>Nuk ka përqindje të përcaktuara nga buxheti total për udhëtim, akomodim, roga, pajisje, kontribut aplikuesi, etj., por ne i nxitim aplikuesit tanë të ofrojnë buxhete realiste që përputhen me trendet e tregut. Aplikuesi duhet të jetë në gjendje të tregojë bindshëm pse kostot e përlogaritura janë të domosdoshme për projektin.</p> <p>Ju lutem vini re që kostot për blerje të aseteve të nevojshme për projektin nuk duhet të kalojnë</p>

		25.000 Lekë.
KRITERET E VLERËSIMIT		
13	Cilat janë kriteret e vlerësimit për propozimet dhe sa pikë ka secili kriter në sistemin e vlerësimit?	<p>Çdo propozim i pranueshëm vlerësohet sipas kriterëve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cilësia e projektit dhe përputhshmëria me thirrjen (30%) - Qartësia e përshkrimit (15%) - Eksperienca e Aplikuesit (30%) - Efikasiteti i Buxhetit (25%)
PROCESI I APLIKIMIT		
14	Do të donim të merrnim dokumentacionin e aplikimit.	<p>Çdo dokument i nevojshëm për aplikimin gjendet falas në swissculturalfund.al në seksionin që korrespondon me thirrjen përkatëse.</p> <p>Fondi Kulturor Zviceran NUK ofron dokumentacion aplikimi me email apo me mjete të tjera përveç faqes zyrtare web.</p>
15	Nuk po gjejmë formularin e aplikimit për thirrjen e granteve rajonale. A ka një formular aplikimi për këtë thirrje?	Nuk ka formular aplikimi për thirrjen e granteve rajonale. Aplikuesit kërkohet të hartojnë propozimin e tyre të projektit sipas termave të referencës që përshkruhen në Udhëzimet e Aplikimit për Thirrjen e Granteve Rajonale.
16	A pranoni aplikime në të dy gjuhët, shqip dhe anglisht?	Aplikimet pranohen në shqip ose anglisht. Nuk është e nevojshme të aplikoni në të dyja gjuhët.
17	A mund të aplikojmë në mënyrë elektronike?	Po, ju mund të aplikoni në mënyrë elektronike. Aplikimet fizike nuk do të pranohen.
18	Cila është adresa e postës elektronike për aplikimet?	Adresa e postës elektronike për aplikimet është: info@swissculturalfund.al
19	A pranohen aplikimet fizikisht?	Aplikimet fizikisht nuk pranohen.
TË TJERA		
20	Në rastin e propozimeve për filma dokumentarë, kërkohet një listë e të intervistuarve, por gjatë produksionit të një dokumentari, kjo listë mund të ndryshojë si	Ne jemi të ndërgjegjshëm që ekziston një gamë e gjerë zhanresh dhe stilesh në mediumin e filmit dokumentar. Ndërkohë që shumë zhanre dokumentarësh mund të marrin drejtime të

	<p>rrjedhje e ngjarjeve të papritura dhe takimeve me personazhe të rinj. Nëse kjo listë është e detyrueshme, a duhet të paraqesim listën e plotë? Sa persona që dihen në datën e aplikimit do ishin mjaftueshëm për këtë listë?</p>	<p>paparashikuara si në koncept ashtu edhe në kalendarin e produksionit, ne kërkojmë të mbështesim vetëm projekte origjinale me synime të qarta, që premtojnë rezultate brenda afateve dhe buxhetit.</p> <p>Ne nuk e përjashtojmë mundësinë e personazheve të paplanifikuar, nëse shtimi i tyre në produksion përmirëson cilësinë e historisë së rrëfyer.</p> <p>Lista e kërkuar nuk kufizohet nga një numër i caktuar të intervistuarish, por duhet që të tregojë shumë qartë se si përfshirja e secilit personazh do të forcojë rrëfimin e historisë.</p>
--	---	---